

P.nr .517/16

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit G. D. nga fsh. D., KK-Gjakovë, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me parg.1 pika 1,4 te KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore –DP në Gjakovë, PP.nr.622/16 të datës 29.08.2016 në shqyrtimin gjyqësor publik, të mbajtur më datë **13.12.2016**, në prani të Prokurorit të shtetit Dëshire Jusaj dhe të akuzuarës G. D. te njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari **G. D.**, bija e P. dhe e M., e lindur me dt. ... në fshatin N. e Eperme K.Gjakovë, tani me banim në fsh. D. KK-Gjakovë, analfabete, pensioniste e gjendjes e varfër ekonomike, shqiptare, shtetase e R. Kosovës, e martuar nënë e dy fëmijëve.

**Ë s h t ë f a j t o r:****Sepse:**

-Me dt. 19.15.2016, rreth orës 12.00, në fshatin D. KK-Gjakovë, saktësisht në shtëpinë e të dëmtuarës M. D. , tjetrës i shkakton lëndime të lehta trupore me dëmtim të përkohshëm të shëndetit, në atë mënyrë që ditën kritike pas një mosmarrëveshje në mes të dëmtuarës M. në njërën anë dhe të akuzuarës G. D. në anën tjetër lidhur me bartjen e disa gjërave që kishin qenë të akuzuarës, e njëjta për një moment e godet me një leftë druri dy herë pas shpine në krah, duke i shkaktuar kështu të dëmtuarës M. D. lëndime të lehta trupore, gjendje kjo e konstatuar nga eksperti mjekoligjor Dr. N. U. e dt.24.07.2016.

**-me çka ka kryer veprë penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me par.1 pika 1.4 te KPRK-së**

Andaj Gjykata në bazë te nenit 4,41,43,49,50,51,73 të KPRK-ës, dhe nenit 188/2 lidhur me par.1 te KPRK-së dhe nenit 365 te KPPK-së, te akuzuarës G. D., i shqipton:

**DËNIM ME KUSHT**

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **3 (tre) muajve**, i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit në afatin prej **1(një) viti** ,nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

E dëmtuara M. D.,për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

E akuzuara obligohet që të paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 20,00 € si dhe në emër të paushallit gjyqësor në shumë prej 20.00 €. në afat prej 15 ditëve, pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.622/16 të dt.29.08.2016, e ka akuzuar të akuzuarën G. D. nga fsh D. KK Gjakovë, duke propozuar që ndaj të aktakuzës të nxjerrë urdhër ndëshkimor me të cilin të njëjtës ti shqiptohet një dënim me gjobë. Gjykata ka pranuar kërkesën e PTH-DP, dhe jashtë shqyrtimit gjyqësor me dt.13.10.2016, ka marr Aktgjykim P.nr.517/16, me te cilën te

akuzuarën e shpall fajtores dhe e dënon me gjobë me shume prej 200 euro, e njëjta është e obliguar që të paguaj shpenzimet procedurale ne shumën prej 20 euro, si dhe ne emër te paushallit gjyqësor shumë prej 30 euro, krejt këtë në afat prej 15 ditësh nen kërcenim te përmbartimit me dhunë. Në afatin ligjor e akuzuara ka parashtruar kundërshtim me dt.20.10.2016 kundër urdhër ndëshkimor me nr.P.nr.517/16 të datës 13.10.2016.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 13.12.2016, përfaqësuesi i PTH-së në Gjakovë , Prokurori Dëshire Jusaj, mbetet në tërësi pranë aktakuzës dhe i propozoi Gjykatës që pas administrimit të provave të njëjtën ta shpall fajtores, ta dënojë sipas ligjit dhe ta obligohet në pagesën e shpenzimeve procedurale.

E akuzuara G. D., pas njoftimit me aktakuzën nen përcjellje dhe interpretimit nga V. D., në shqyrtimin gjyqësor thekson se e pranon ne tersi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimit te fajësisë dhe atë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion , shtoj se këtë vepër e kam kryer për shkak te revoltës, jam penduar për veprën e kryer, premtojë se një veprim i tillë nuk do të përsëritet, andaj i propozoj gjykatës qe te merr parasysh rrethanat lehtësuese si parimin e fajësisë, gjendjen e varfër ekonomike, faktin se asnjëherë me parë nuk kam ndesh me ligjin të shqiptojë një dënim me të butë.

Pasi gjykata ka fituar bindjen se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprën penale që i vihet në barrë dhe është bindur se pranimin e ka bërë në baza vullnetare, duke u mbështetur edhe në faktet dhe provat që i përmban Aktakuza, ka gjetur se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga neni 326 par.4 te KPPK-së, dhe shqyrtimin gjyqësor e ka përfunduar pa administrimin e provave.

Me rastin e matjes së dënimit, gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga e akuzuara, pendimin e saj, sjelljen korrekte të akuzuarës në gjykim, premtimi i saj se në të ardhmen nuk do të përsërisë ndonjë vepër penale, kërkim falja nga e dëmtuara për dëmin e shkaktuar, gjendjen e varfër ekonomike, të cilat rrethana ndikuan që Gjykata ti zbatoi dispozitat e zbutjes së dënimit të parapara me nenin 75 të KPRK-së, Gjykata të akuzuarës i shqiptoi dënim me kusht ne kohëzgjatje prej **3 (tre) muajve**, me kusht që e akuzuara brenda kohës se verifikimit në afatin **prej 1 (një) viti** të mos kryejnë vepër tjetër penale, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë nga neni 41 te KPK-së.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar ne kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike u murr konform nenit 463 te KPPK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor bazohet në dispozitat e nenit 450 par.1 dhe 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.6 te KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,  
P. nr.517/16 më datë 13.12.2016.**

**Sekretarja juridike,  
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,  
Ilirjana Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi mund te paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatës së Apelit ne Prishtinë. Ankesa ne kopje te mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate